



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCIVE

**RAPORT 6 MUJOR I VITIT 2026, PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK
TË REALIZUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE**

1. Përmbledhja ekzekutive (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me
mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2026, Ministria e Financave, ka realizuar konsultime publike për projektatet në zbatim të nenit 1 të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, i cili përcakton procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projektdokumentet strategjike kombëtare.

Ministria e Financave ka miratuar 4 akte objekt i konsultimit publik, dhe ka realizuar në masën 100% konsultimin publik për të gjitha projektaktet e miratuara për periudhën e raportimit.

Ministria e Financave, ka publikuar pas procesit të konsultimit publik të projektakteve si më poshtë detajuar, edhe raportet përkatëse individuale për rezultatet e konsultimit publik¹ për secilin projektakt të publikuar në Regjistër, duke përmbushur parimin e reagueshmërisë dhe llogaridhënies së këtij procesi.

Krahasuar me vitet e kaluara performanca institucionale e MF është me rritje, duke shënuar progres në rritjen e numrit të akteve të konsultuara ashtu si dhe në cilësinë e procesit. Metodatat e përzgjedhura për konsultim dhe targetimi i duhur i palëve të interesit ka ndikuar në hartimin e politikave dhe legjislacionit më cilësor, gjithëpërfshirës dhe efikas.

Përmirësimet në këtë proces janë tregues i zhvillimit të një qasje të integruar për planifikimin dhe menaxhimin e konsultimeve publike për projektaktet dhe politikat e Ministrisë së Financave, si një hap thelbësor për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies.

Digjitalizimi i procesit të konsultimit ka bërë të mundur rritjen e pjesëmarrjes së publikut nëpërmjet Regjistrit Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, të cilët gjatë këtij 6-mujori kanë përcjellë komentet e tyre jo vetëm në RENJKP por edhe në adresën elektronike të koordinatorit për Konsultimin Publik për Ministrinë e Financave.

¹ <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Institucioni/4>

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Akte të miratuara për periudhën e 6-mujorit të parë të vitit 2026 nga Ministria e Financave, ka qenë në total 49 akte. Nga këto akte nga Ministria e Financave janë miratuar 44 akte, ndërsa 5 prej tyre janë bashkëpropozim me ministri të tjera.

2.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Gjithsej 4 projektakte kanë qenë objekt konsultimi, dhe që janë konsultuar nëpërmjet metodave të ndryshme konsultative, përfshirë takimet konsultative me grupet e interesit, komunikimeve zyrtare dhe elektronike, si dhe nëpërmjet publikimit në RENJKP.

Aktet të miratuara për periudhën dhe për të cilat janë zhvilluar konsultime publike, janë:

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;
2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
3. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”
4. Projektvendimi “Për miratimin e Programit të Reformave Ekonomike 2026-2028”.

Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, ka pasqyruar kërkesat e dërguara në rrugë zyrtare pranë Ministrisë së Financave nga grupet e interesit përkatëse, duke përfshirë aktorët e rëndësishëm të interesit, por nuk është publikuar në RENJKP, është publikuar Raporti Individual i Konsultimit Publik në RENJKP.

2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar dhe projektvendimi “Për miratimin e Programit të Reformave Ekonomike 2026-2028”, nuk janë objekt i procesit të vlerësimit të ndikimit sipas përcaktimeve të pikës 45/1 të rregullores së Këshillit të Ministrave.
- Ndërsa për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, është hartuar raporti i vlerësimit të ndikimit

dhe është publikuar në rubrikën përkatëse të projektligjit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

- Për sa i përket projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, informojmë se në zbatim të VKM nr.584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar, ky projektakt është i përjashtuar nga detyrimi i kryerjes së vlerësimit të ndikimit.

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Ministria e Financave ka parashikuar në Program Analitik miratimin e 26 akteve, ku për 15 prej tyre aplikohen përjashtimet e parashikuara në shkronjën “c”, të nenit 4, të ligjit “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Në PKIE për vitin 2026 janë parashikuar miratimi i 4 akteve, ndërsa 3 janë aktet për të cilat janë aplikuar kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik.

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Janë konsultuar 3 projektligje dhe 1 projektvendim.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Procesi i konsultimit publik në krahasim me vitin e kaluar është përmirësuar. Numri i akteve të cilat i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik për periudhën Janar – Qershor 2026 është rritur, në krahasim me të njëjtën periudhë të viteve të kaluara,. Për këtë 6-mujor është rritur cilësia e menaxhimit të këtij procesi, si dhe targetimi i duhur i aktorëve të përfshirë. Metodave të përzgjedhura për konsultimin janë diversifikuar si dhe konstatohet rritje e numrit të pjesëmarrësve në proces. Ky konstatim vjen nga numri i komenteve të përcjella në regjistrin, si dhe nëpërmjet metodave të tjera të konsultimit.


2.2. Metodave të konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Të gjitha projektaktet e miratuara për periudhën Janar-Qershor 2026 objekt i konsultimit publik, janë konsultuar nëpërmjet metodave të ndryshme të konsultimit:

Metodat e tjera të përzgjedhura për konsultim publik janë:

- Regjistri Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik për 3 akte;
- Konsultimi nëpërmjet postës elektronike është aplikuar për 4 akte;
- Konsultim nëpërmjet mekanizmit IPMG 1 akte;
- Takime konsultative me prezencë 3 akte.



2.2.2 Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Të gjitha metodat e konsultimit kanë gjeneruar komente. Ndërkohë që numrin më të lartë të komenteve e ka gjeneruar metoda e konsultimit në tryeza konsultative.

2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Për të tre projektaktet e konsultuara, janë zhvilluar konsultime paraprake që në fazën e hartimit.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

Konsultimet publike në RENJK kanë qenë të hapura për të paktën 20 ditë pune, duke përmbushur afatin e kërkuar nga ligji.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Për aktet e sipërcituara kohëzgjatja mesatare e konsultimit ka qenë 1 muaj (20-21 ditë pune).

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Situata është përmirësuar krahasuar me vitin e kaluar. Duke krahasuar me vitet e shkuara, në Regjistrin Elektronik për Konsultimet Publike ka pasur më shumë komente nga grupe interesi, të cilat lidhen me akte që do të miratohen në periudhën e ardhshme të raportimit.

2.4 . Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

- ✚ Në procesin e hartimit dhe konsultimit për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar , u angazhuan 3 aktorë të jashtëm, të cilët përfshinin një gamë të gjerë aktorësh nga organizata, ekspertë të pavarur;
- ✚ Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, u angazhuan 17 aktorë të jashtëm, nga organizata, ekspertë të pavarur, si dhe shoqëri audituese në vend;
- ✚ Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, u angazhuan 2 aktorë të jashtëm
- ✚ Për projektvendimin “Për miratimin e Programit të Reformave Ekonomike 2026-2028”, u angazhua 1 aktor i jashtëm.

2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

Struktura e anëtarëve të jashtëm, që kanë marrë pjesë në hartimin dhe konsultimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, si më poshtë:

- SCiDEV
- AL-TAX
- Partners Albania

Lidhur me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, struktura e anëtarëve të jashtëm që kanë marrë pjesë në hartimin dhe konsultimin, ka qenë si më poshtë:

- Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
- Kalo & Associates
- EY Albania
- ShP GAZ
- Antea Cemant
- BCCA
- Instituti i Kontabilistëve të Miratuar
- Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
- AAB
- Tirana Bank
- SAINT - GOBAIN
- FORVIZ MAZARS
- Coca Cola Bottling Shqipëria Shpk
- Deloitte Audit Albania
- Konfindustria
- Dhoma Italiane e Tregtisë (CCIA)
- Bordi i Mbikëqyrjes Publike

Për projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, aktorët e jashtëm që u angazhuan kanë qenë:

- Individë/Pensionistë rezidentë në Shqipëri ose që synojnë të jetojnë në Shqipëri
- Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë

Për projektvendimin “Për miratimin e Programit të Reformave Ekonomike 2026-2028”, aktori i jashtëm i përfshirë ka qenë:

- Center of Excellence in Finance (CEF)

2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projektaktet në vitin e caktuar?

Në 4 projektaktet e konsultuara, ka patur në total 23 palë interesi të përfshirë në procesin e konsultimit, nga të cilët 12 prej tyre dhanë komente për përmirësimin e metejshëm të akteve të paraqitura për konsultim.

Titulli	Palë interesi pjesmarrës	Palë interesi kontribues
Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar	3	3
Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”,	17	6
Projektvendimi “Për miratimin e Programit të Reformave Ekonomike 2026-2028”	1	1
Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”	2	2
Total	23	12

2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Ka përmirësime lidhur me indeksion sasiore, është rritur shkalla e konsultimeve publike të realizuara nga Ministria e Financave. Rritja e interaktivitetit të RENJK dhe përdorimi i instrumentave digjital në proces ka rritur aksesin e grupeve të interesit dhe publikut në vendimarrje, duke u krijuar mundësinë për të dërguar komentet dhe reagimet e tyre për aktet e publikuara për konsultim.

Në krahasim me vitin e kaluar situata ka pasur përmirësime të dukshme lidhur me realizimin e indeksit të procesit të konsultimit.


2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?

Nga procesi i konsultimit publik të 4 akteve janë mbledhur 72 komente gjithsej.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Numri total i komenteve të pranuar plotësisht është 27 komente. Numri total i komenteve të pranuar pjesërisht është 2 komente, dhe i atyre të refuzuara është 43 komente.



Kategorizimi i komenteve të refuzuara

- Refuzuar pasi komenti lidhej me ndërhyrje jashtë objektit të projektaktit; **4 Komente**
- Refuzuar pasi komenti lidhet me ndërhyrje jashtë kompetencës së institucioneve të qeverisjes qendrore; **1 Koment**
- Refuzuar pasi komenti gjen zgjidhje në një projektakt tjetër ligjor/nënligjor; **20 Komente**
- Refuzuar pasi komenti bie ndesh me procedurat/afatet e ndjekura nga institucionet e Bashkimit European në kuadër të Acquis që po transpozohet. **18 Komente**

2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Konstatohet një ndryshim i trendit të mbledhjes së komenteve, ku metodat elektronike të konsultimit nëpërmjet postës email apo RENJKP gjenerojnë numër të konsiderueshëm komentesh. Gjithashtu, dhe mekanizmat konsultativ këshillimor janë konsultuar gjithashtu edhe nëpërmjet postës elektronike.

2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?

Nga aktet e konsultuara 1 raport VNR është ndryshuar pas procesit të konsultimit publik.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Ministria e Financave gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2026, pas mbylljes së procesit të konsultimit publik sipas afatit referuar ligjit nr.146/2014 ka publikuar Raportet individuale për rezultatet e

konsultimit publik² për 3 projektaktet e publikuara në Regjistër si dhe raportin e konsultimit publik për projektligjin “Për disa shtesa në ligjin nr.29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i konsultuar jashtë RENJKP.

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Të gjitha Raportet Individuale të Konsultimit Publik u publikuan në regjistër.

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

Në përfundim, bazuar në vlerësimin e cilësisë së performancës institucionale sipas metodologjisë Sigma, Ministria e Financave ka performuar me një mesatare pikëzimi cilësie për aktet e konsultuara nga 8 pikë maksimale.

3 akte janë konsultuar me cilësinë maksimale 8 pikë.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik për Ministrinë e Financave, lidhen më së shumti me gjithëpërfshirjen e aktorëve në këtë proces. Ministria e Financave do të synojë që gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2026 të ketë përfshirje aktive të shumë aktorëve në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projektakteve që hartohen duke kombinuar dhe përdorur disa metoda të procesit të konsultimit publik, si mundësia më e mirë për të arritur një rezultat efikas në të ardhmen. Gjithashtu, vlerësohet se edhe angazhimi nëpërmjet rrjeteve sociale duke u realizuar edhe në kombinim me metodat e tjera të konsultimit publik do të sjellë rritje të përfshirjes dhe mundësive në këtë kuadër.

² <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Institucioni/4>